

URDHËR
Nr. 6879/2, datë 31.10.2013

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 27 të ligjit nr. 8485, datë 15.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të kreut V, pika 2/a të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Autorizimet për dërgimin me shërbim të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit jashtë qendrës së punës, brenda vendit në largësi mbi 100 km, të lëshohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Rezervave Materiale të Shtetit, z. Irfan Dashi.

2. Në ushtrimin e kësaj kompetence, Drejtori i Përgjithshëm i Rezervave Materiale të Shtetit të zbatojë kriteret e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar.
7639

3. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Rezervave Materiale të Shtetit për zbatimin e këtij urdhri.

4. Çdo urdhër që bie në kundërshtim me këtë urdhër, revokohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri